

VOLTALIA: KARAVASTA PV

Vendi:	SHQIPËRI
NUMËR PROJEKTI:	53261
Sektori i Biznesit:	Energji
Lloji i Njoftimi:	PRIVAT
Kategoria Mjediore:	A
Data e synuar e aprovimit:	15 Nëntor 2022
Statusi:	I aprovuar në koncept
Publikimi i DPP:	22 Shtator 2022

Përshkrimi i Projektit

Dhënia e një huaje afatgjatë për të financuar ndërtimin dhe operimin e Parkut Solar (SPP) të Karvastasë, një park prej 140MW me vendndodhje në bashkinë Fier ("Projekti"). Projekti është rezultat i një tenderi ndërkombëtar i mbështetur nga Banka dhe do të implementohet nga Karavasta Solar shpk, një kompani me qëllim të vecantë, e themeluar në Shqipëri, në pronësi 100% të Voltalia SA, një shoqëri ndërkombëtare për energjitë e rinovueshme, e listuar në Euronext Paris.

Objektivat e Projektit

Projekti do të kontribuojë në mitigimin e efekteve klimatike nëpërmjet rritjes së ndjeshme të gjenerimit nga burime diellore në Shqipëri dhe nëpërmjet promovimit të pjesëmarrjes së projekteve me kapital privat në një sektor që dominohet nga asetet publike dhe energjia e importuar.

Ndikimi në Tranzicion

ETI: 100

Ndikimi në tranzicion rrjedh nga benefitet që sjell Projekti për mitigimin e efekteve klimatike nëpërmjet ndërtimit të 140 MW kapacitete shtesë gjeneruese të energjive të rinovueshme në Shqipëri. Tenderi ndërkombëtar, rezultat i të cilit është Projekti, është unik në aspektin e promovimit të zhvillimit të tregjeve lokale të energjisë duke bërë të mundur që Projekti të ketë 50% të gjenerimit subjekt të dinamikave të tregjeve të energjisë. Implementimi me sukses i Projektit pritet të ketë një efekt demonstrimi të rëndësishëm për investitorët dhe institucionet financiare të cilët duan të angazhohen, dhe mbështesin, zhvillimin e energjive të rinovueshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Informacion për Klientin

Voltalia SA është një shoqëri ndërkombëtare e energjive të rinovueshme e listuar në Euronext Paris.

Përmbledhja e Financimit të BERZH

EUR 33,000,000.00

Kostoja Totale e Projektit

EUR 136,000,000.00

Vlera e shtuar

Banka ka një rol qëndror dhe kryesor në strukturimin e financimit të kërkuar për implementimin e Projektit, si dhe në mobilizimin e një pjesëmarrjeje të ndjeshme komerciale në këtë financim.

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

Kategoria A (2019 PMS, ESP anglisht). Zhvillimi i një projekti SPP prej 140 MW së bashku me një linjë transmetimi ajrore (OHTL), e vendosur në një Zonë me Rëndësi për Shpendët dhe ngjitur me një Vend Kandidat Emerald dhe zone Ramsar, është i asociuar me mundësi për ndikime në biodiversitet, shoqëri dhe jetesë, që rezultojnë nga marrja e tokës, si dhe mundësi për ndikime në shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë ndërtimit ose operimit. Projekti kërkonte zhvillimin e një Vlerësimi gjithëpërfshirës të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS, ESIA në anglisht) në përputhje me KP-të e BERZH-it, si dhe paketën suplementare të PJT, PVMS, PSM dhe PZHJ (respektivisht nts, ESAP, SEP dhe LRP në anglisht). Paketa VNMS (ESIA) është publikuar për 60 ditë, që prej 31 gusht 2022 në faqet e internetit të Klientit dhe BERZH. Asnjë problem nuk është ngritur deri më sot.

Analiza e Diligjencës Mjedisore dhe Sociale (ADMS, ESDD në anglisht) dhe VNMS së Projektit është ndërmarrë nga një konsulent pavarur. Projekti është rezultat i një tenderi i cili u mbështet gjerësisht nga BERZH përmes asistencës teknike, duke përfshirë një kontroll paraprak për rreziqet në aspektet mjedisore dhe sociale. Sponsor i është një klient ekzistues i Bankës dhe Banka është gjithashtu një aksioner i vogël i Voltalia që prej viti 2019.

Monitorimi i projekteve ekzistuese ka konfirmuar se Voltalia është përgjithësisht në rrugën e duhur me zbatimin e PVMS-ve sikurse është rënë dakord për projekte të mëparshme; ka sisteme të përshtatshme të menaxhimit Mjedisor dhe Social dhe ka kapacitet institucional për të zbatuar Projektin në përputhje me KP-të e Bankës. Struktura dhe sistemet e menaxhimit të Mjedisit, Sigurisë dhe Shëndetit (MSSH, EHS në anglisht) në nivel të projektit janë krijuar dhe tashmë janë plotësisht funksionale.

Vendndodhja e SPP është ngjitur me Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, një Vend Kandidat Emerald sipas Konventës së Bernës që përfshin zonën Ramsar të Lagunës së Karavastasë. Vendndodhja e Projektit gjithashtu mbivendoset pjesërisht me Zonën Kryesore me Biodiversitetit (ZKB) në Lagunën e Karavastasë dhe Zonë me Rëndësi për Shpendët (ZRSH) e përcaktuar për speciet e shpendëve të kërcënuar globalisht, bashkësitë e rëndësishme të zogjve ujorë dimëruar dhe mbarështues, si edhe për Bretkosa e Ujit endemike Shqiptare. Një vlerësimi gjithëpërfshirës i biodiversitetit,

duke përfshirë Vlerësimin Kritik të Habitatit (VKH, CHA në anglisht), Vlerësimin e Duhur (VD, AA në anglisht) dhe Vlerësimin e Shërbimeve të Ekosistemeve (CSHE, ESA në anglisht) janë ndërmarrë nga një grup ekspertësh ndërkombëtarë të biodiversitetit dhe Plani gjithëpërfshirës i Veprimit për Biodiversitetin (PVB, BAP në anglisht) dhe Plani i Menaxhimit të Biodiversitetit (PMB, BMP në anglisht) është përgatitur për projektin me qëllim adresimin e rreziqeve të mundshme dhe përfshin shmangien, monitorimin dhe menaxhimin e ndikimeve të mundshme negative në zonat e mbrojtura dhe vlerave të biodiversitetit. Konsultimet u zhvilluan edhe me Autoritetet Kompetente dhe Administratën e Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta.

Toka e disponueshme për SPP është 196 hektarë (ha), ku vendndodhja (gjurma) e propozuar e Projektit zë një total prej 185 hektarë. OHTL 220 kV do të shtrihet përafërsisht 19.2 km në drejtimin juglindor nga zona e nënstacionit të Projektit në deri në nënstacionin e Fierit.

Nuk ka zhvendosje fizike lidhur me këtë Projekt. Megjithatë, vendndodhja e SPP dhe OHTL do të ndikojnë në përdorimin e tokës, kryesisht sepse ka lidhje me humbjen e tokës dhe zhvendosjen ekonomike në zonat kryesisht bujqësore. Ndikimet që lidhen me blerjen e tokës menaxhohen nëpërmjet zbatimit të PZHJ (LRP në anglisht). PLZHJ është formuluar me të dhëna nga Familjet e prekura nga Projektin dhe do të nënshtrohen një auditimi të pavarur pas përfundimit për të verifikuar nëse jetesa është rikthyer në nivelet para Projektit.

Për komponentët diellorë të projektit është kryer një analizë e zgjeruar e zinxhirit të furnizimit të tyre. Ekzistojnë sisteme funksionale të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit dhe politika që nxjerrin në pah një tolerancë zero ndaj shkeljeve të punës, duke përfshirë Kodin e Sjelljes, këto kërkesa janë përcjellë nga banka te huamarrësit, e në vazhdim tek kontraktori KPM dhe në të gjithë zinxhirin e furnizimit për modulet FV.

Marrëveshja e financimit do të kërkojë që projekti të tregojë kujdesin e duhur dhe procedurat e menaxhimit për sigurimin (prokurimin) e moduleve diellore. Për këtë projekt është marrë një hartë e zinxhirit të furnizimit, e cila ka mundësuar gjurmimin e niveleve të polisilikonit, dhe e cila do të konfirmohet nga një auditor (palë e tretë) dhe do të monitorohet nga Banka.

Rreziqet dhe ndikime të tjera të mjedisore dhe sociale pritet të përfshijnë: kapacitetin dhe sistemet e menaxhimit mjedisore dhe sociale të kompanisë dhe kontraktorit; mekanizmi i angazhimit të palëve të interesit dhe ankesave; punën dhe kushtet e punës duke përfshirë Shëndetin dhe Sigurinë në Punë (SHSP), ndikimi i mundshëm i COVID19, mekanizmi i ankesave të punëtorëve, mosdiskriminimi dhe mundësitë e barabarta; gatishmëria për emergjencë; ndikimet në komunitet. Për të adresuar rreziqet mjedisore dhe sociale është zhvilluar, dhe dakordësuar me Klientin, dhe një PVMS.

Banka do të monitorojë zbatimin e Projektit në baza tremujore përmes raporteve të Këshilltarëve Teknik të Huadhënësve si dhe çdo vit nëpërmjet Raporteve Vjetore Mjedisore dhe Sociale (RVMS).

Bashkëpunimi teknik dhe grantet

Projekti është një produkt i një bashkëpunimi teknik me Qeverinë e Shqipërisë në vlerën rreth EUR 1 milion për të prokuruar në mënyrë konkurruese kapacitete të mëdha voltaike. Bashkëpunimi teknik përfshin: i) përgatitjen e kuadrit ligjor për prokurimin konkurrues të kapaciteteve të mëdha teknike, ii) prokurimin konkurrues të një projekti të madh si pasojë e përgatitjes së kuadrit ligjor, dhe iii) krijimi i operatorit të energjive të rinovueshme.

Informacion për Kontaktimin e Shoqërisë

Xavier Mulliez

x.mulliez@votalia.com

+33 6 45 26 74 59

<https://ëëë.votalia.com/>

Ndërtesa ETC, Bulevardi Bajram Curri, Kati 9, Zyra 3, Tirana, Albania

PSD është rishikuar më:

19 Oct 2022

Ndikimi në Tranzicion

Për informacion të mëtejshëm lidhur me qasjen e BERZH ndaj matjes së ndikimit në tranzicion mund të lexoni [këtu](#).

Mundësitë e biznesit

Për mundësitë për biznes ose prokurim, kontaktoni Klientin.

Për mundësi biznesi me BERZH (që nuk lidhen me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168

Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet në sektorin shtetëror, vizitoni Prokurimet e BERZH:

Tel: +44 20 7338 6794

Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Mund të bëni pyetje specifike duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH-it](#).

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

[PMS](#) dhe Kriteret e Performancës (PR) përcaktojnë mënyrën se si BERZH zbaton angazhimin e saj për promovimin e “zhvillimit të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm mjedisor”. PMS dhe PR përfshijnë dispozita specifike në mënyrë që klientët të veprojnë në përputhje me kërkesat e zbatueshme të legjislacionit kombëtar për informacionin dhe këshillimin publik, si dhe të ngrenë mekanizmat e ankimit për të adresuar dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, veçanërisht sa i përket përgjegjësisë mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në raport të drejtë me natyrën dhe shkallën e riskut dhe ndikimit mjedisor dhe social të projektit, BERZH i kërkon klientëve të publikojnë gjithashtu informacion, sipas rastit, mbi risqet dhe ndikimet e

projektit ose të kryejnë këshillime gjithëpërfshirëse me palët e interesit dhe të marrin në konsideratë e t'i përgjigjen reagimit të tyre.

Më shumë informacion mbi praktikën e BERZH në këtë aspekt jepet në [PMS](#).

Integriteti dhe Përputhshmëria

Zyra e Krye Oficerit të Përputhshmërisë (OCCO) së BERZH promovon qeverisjen e mirë dhe siguron zbatimin e standardeve më të larta të integritetit në të gjitha veprimtaritë e Bankës, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare. Të gjithë klientëve e Bankës duhet t'u nënshtrohen kontrolleve të integritetit për t'u siguruar që projektet nuk paraqesin rrisqe të papranueshme integriteti apo reputacioni për Bankën. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e problematikave gjatë fazave të vlerësimit për miratimin e projektit, është mënyra më efikase për të siguruar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse dhe gjithashtu ndihmon me monitorimin e rreziqeve ndaj integritetit në fazën e pas investimit në projekt. OCCO është gjithashtu përgjegjëse për verifikimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe shkelje në projektet e financuara nga BERZH Kushdo, qoftë pjesë apo jo e Bankës, që ka dyshime për praktika mashtrimi apo korruptive duhet të paraqesë një raportim me shkrim në adresë të Krye Oficerit të Përputhshmërisë përmes postës elektronike tek compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të ndiqen nga OCCO. Të gjitha raportimet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportimet mund të bëhen në çfarëdolloj gjuhe të Bankës apo të vendeve ku Banka vepron. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika e Qasjes në Informacion (PQI)

PQI përcakton mënyrën se si BERZH e shpalos informacionin dhe këshillohet me grupet e interesit për të nxitur ndërgjegjësimin dhe të kuptuarit më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta pas hyrjes në fuqi të saj më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e [Politikës së Qasjes në Informacion](#) për t'u informuar mbi informacionin e disponueshëm në faqen e BERZH.

Kërkesat për informacion të veçantë mund të bëhen duke përdorur [Formularin e pyetjeve të BERZH](#).

Mekanizmi i Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP)

Nëse përpjekjet për të trajtuar shqetësimet mjedisore, sociale, apo të bërjes publike me Klientin apo Bankën nuk kanë rezultat (p.sh., përmes mekanizmit të ankimimit në nivel projekti të Klientit, ose përmes kontaktit të drejtpërdrejtë me ekipin drejtues të Bankës) individët dhe organizatat mund t'i trajtojnë shqetësimet e tyre përmes Mekanizmit të Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit (MPPP) të BERZH.

MPPP shqyrton në mënyrë të pavarur problematikat e Projektit që mendohet se kanë (ose mund të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i mekanizmit është të: mbështesë dialogun midis palëve të interesit të Projektit për të zgjidhur problematikat mjedisore, sociale dhe të publikimit të informacionit; të përcaktojë nëse Banka vepron në përputhje me [Politikën Mjedisore dhe Sociale](#) apo dispozitat specifike për Projektin të [Politikës së Qasjes në Informacion](#); dhe nëse gjen zbatim të trajtojë çdo devijim nga këto politika, duke parandaluar kështu edhe cdo devijim apo mospërputhje nga ana e Bankës në të ardhmen.

Ju lutem vizitoni faqen e ëebit për [Mekanizmin e Pavarur për Përgjegjësinë ndaj Projektit](#) për të mësuar më shumë mbi MPPP dhe misionin e tij; si dhe për të [dërguar një kërkesë](#) për rishikim; ose për të kontaktuar MPPP përmes emailit ipam@ebrd.com për më shumë informacion dhe udhëzime mbi mekanizmin dhe dërgimin e kërkesave.